

**Universiteti i Prishtinës**  
**Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore**  
**Departamenti i Gjeografisë**  
**Programi: Gjeografi master**



**Analizë e lëvizjes së numrit të popullsisë në komunat e Kosovës sipas regjistrimit të popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare, 2024**

Mentori  
Prof. Asoc. Dr. Mimoza Dushi

Kandidatja  
Leonita Xhekaj

Prishtinë, 2025

# **Analizë e lëvizjes së numrit të popullsisë në komunat e Kosovës sipas regjistrimit të popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare, 2024**

## **Abstrakt**

Regjistrimi i popullsisë është një proces kyç statistikor, i cili siguron informacion të detajuar mbi madhësinë, strukturën dhe karakteristikat socio-ekonomike të një vendi. Ai përbën një burim të rëndësishëm për planifikimin e politikave qeveritare, menaxhimin e burimeve dhe ofrimin e shërbimeve publike, si dhe për zhvillimin e strategjive afatgjata në sektorë të ndryshëm, si arsimi, shëndetësia, infrastruktura dhe ekonomia. Informacioni i siguruar nga regjistrimi është thelbësor për kuptimin e ndryshimeve demografike, për identifikimin e nevojave të popullsisë dhe për përcaktimin e prioriteteve në zhvillimin e qëndrueshëm. Në këtë kontekst, analiza e numrit të popullsisë në komunat e Kosovës ofron një pasqyrë të qartë mbi shpërndarjen territoriale, karakteristikat socio-ekonomike dhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm në zhvillimin lokal. Ky studim synon të shqyrtojë ndryshimet e numrit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në komunat e Kosovës, duke u bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2024 dhe duke i krahasuar me rezultatet e regjistrimit të vitit 2011. Qëllimi është të evidentohen tendencat kryesore të rritjes ose tkurrjes së popullsisë në nivel komunal dhe rajonal, të identifikohen faktorët kryesorë që ndikojnë në këto ndryshime dhe të vlerësohet ndikimi i tyre në zhvillimin socio-ekonomik dhe planifikimin e shërbimeve publike. Metodologjia e përdorur në këtë studim kombinon analizën e literaturës shkencore, të dhënave nga regjistrimet zyrtare dhe krahasimin e periudhave të ndryshme. Analiza u fokusua në identifikimin e tendencave të ndryshimit të popullsisë në komunat urbane dhe rurale, duke marrë parasysh faktorë socio-ekonomikë, migrimin e brendshëm dhe të jashtëm, urbanizimin, transformimet në strukturën familjare dhe zhvillimin e infrastrukturës. Për realizimin e qëllimit të studimit janë përdorur të dhëna primare nga regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave të vitit 2024, të kombinuara me analizën e literaturës ekzistuese. Metoda analitike ka përfshirë krahasimin e regjistrimeve të viteve 2011 dhe 2024, për të identifikuar trendet e rritjes ose tkurrjes së popullsisë, ndryshimet në strukturën gjinore, shpërndarjen urbane dhe rurale, si dhe ndikimin e faktorëve socio-ekonomikë dhe migratorë. Analiza përfshin gjithashtu kategorizimin e komunave sipas madhësisë së qyteteve, duke përdorur klasifikimin e përdorur nga auroti Hivzi Islami, i cili

përcakton qytetet e mëdha, të mesme dhe të vogla, si dhe qytezat më të vogla. Metoda krahasuese dhe analitike e përdorur mundëson të kuptohet jo vetëm numri i popullsisë, por edhe ndryshimet në shpërndarjen territoriale dhe ndikimin e këtyre ndryshimeve në planifikimin e politikave lokale dhe kombëtare. Rezultatet e analizës për vitin 2024 tregojnë se Kosova numëron gjithsej 1,585,566 banorë, me një strukturë gjinore pothuajse të balancuar: 50.2% meshkuj dhe 49.8% femra. Kjo pasqyron një ekuilibër të qëndrueshëm gjinor, i cili është tipik për një shoqëri me dinamikë demografike stabile. Shpërndarja hapësinore tregon se 50.18% e popullsisë jeton në zonat urbane, ndërsa 49.8% në zonat rurale, duke treguar një përpjekje të vazhdueshme drejt një shpërndarjeje më të barabartë të popullsisë në të gjithë territorin e vendit dhe duke reflektuar një proces gradual të urbanizimit. Analiza sipas madhësisë së qyteteve tregon se qytetet kryesore të mëdha, si Prishtina me 227,882 banorë, Prizreni me 147,246 banorë dhe Ferizaji me 109,255 banorë, mbajnë përqendrimin më të madh të popullsisë urbane dhe përfaqësojnë qendrat më të rëndësishme ekonomike, arsimore dhe administrative të vendit. Qytetet e mesme, përfshirë Gjilanin (82,980), Pejën (82,745), Podujevën (70,975), Gjakovën (78,699) dhe Mitrovicën (64,742), kanë gjithashtu një përqendrim të konsiderueshëm të popullsisë urbane, duke ofruar mundësi të mira për punësim dhe shërbime. Nga ana tjetër, qytetet dhe qytezat e vogla si Graçanica (18,486), Shtërpca (10,710), Hani i Elezit (8,533), Juniku (3,943) dhe Mamusha (5,607) përfaqësojnë zona me popullsi të kufizuar, shpesh me karakteristika të veçanta etnike ose administrative. Ky diversitet tregon se Kosova ka një strukturë komplekse demografike, ku përqendrimi i popullsisë është i lidhur ngushtë me mundësitë ekonomike dhe arsimore. Krahasimi me regjistrimin e vitit 2011 tregon ndryshime të dukshme në shpërndarjen e popullsisë. Për shembull, Prishtina ka vazhduar të rritet për shkak të përqendrimit të mundësive për punësim, arsimin dhe shërbimet publike, ndërsa komunat rurale si Lipjani, Malisheva dhe Vushtrria kanë pësuar tkurrje për shkak të migrimit të brendshëm drejt qyteteve dhe emigrimit jashtë vendit, si dhe për shkak të mungesës së mundësive ekonomike. Kjo tendencë pasqyron sfidat që lidhen me ruajtjen e karakterit rural dhe nevojën për zhvillim të qëndrueshëm në këto zona. Faktorët kryesorë që ndikojnë në ndryshimin e popullsisë përfshijnë: zhvillimin ekonomik dhe industrial të komunave urbane, urbanizimin dhe përqendrimin e shërbimeve publike dhe arsimore, migrimin e brendshëm dhe emigrimin jashtë vendit, transformimet në strukturën familjare, zhvillimin e infrastrukturës dhe politikat lokale e kombëtare. Popullsia urbane përqendrohet në qendrat ekonomike dhe administrative për shkak të

mundësive më të mëdha për punësim, arsim dhe shërbime, ndërsa popullsia rurale ruan lidhjet historike me tokën, bujqësinë dhe zakonet lokale. Analiza e shpërndarjes territoriale dhe krahasimi me regjistrimin e vitit 2011 tregon një mozaik të larmishëm demografik. Rajonet urbane shfaqin rritje të popullsisë dhe përqendrim të lartë të shërbimeve, ndërsa rajonet rurale përballen me tkurrje dhe një përqendrim të ulët të mundësive ekonomike. Ky mozaik është një tregues i qartë i diversitetit socio-ekonomik dhe demografik të Kosovës dhe nënvizon rëndësinë e analizës së hollësishme për të kuptuar sfidat dhe mundësitë e zhvillimit komunal. Për më tepër, studimi thekson se faktorët e migracionit, urbanizimit dhe transformimeve në strukturën familjare ndikojnë jo vetëm në shpërndarjen e popullsisë, por edhe në zhvillimin e tregut të punës, planifikimin urban dhe politikën sociale në nivel lokal dhe kombëtar. Krahasimi midis regjistrimeve të viteve 2011 dhe 2024 ofron një kuptim të qartë të dinamizmit demografik dhe ndihmon në identifikimin e komunave me rritje të shpejtë ose tkurrje të konsiderueshme të popullsisë, duke mundësuar planifikim më të saktë për zhvillimin lokal dhe kombëtar. Në përmblidhje, ky studim ofron një analizë të plotë dhe të thelluar të ndryshimeve demografike dhe ekonomike nëpër komunat e Kosovës, duke evidentuar tendencat e urbanizimit dhe tkurrjes së popullsisë rurale, ndikimin e faktorëve socio-ekonomikë dhe migracionit, si dhe rëndësinë e këtyre ndryshimeve për zhvillimin e qëndrueshëm. Rezultatet e këtij studimi sigurojnë një bazë të rëndësishme për hulumtime të mëtejshme mbi migrimin, urbanizimin, zhvillimin socio-ekonomik dhe menaxhimin e burimeve në Kosovë, duke kontribuar në përmirësimin e politikave dhe strategjive zhvillimore në nivel vendi.

**Fjalët kyçe: Regjistrimi i popullsisë, Popullsia, Komunat, Urbanizimi, Migrimi, Shpërndarja territoriale...**

# **Analysis of Population Dynamics Across Municipalities in Kosovo Based in the 2024 Census of Population, Housing, and Household**

## **Abstract**

The population census is a key statistical process that provides detailed information on the size, structure, and socio-economic characteristics of a country. It represents an essential source for government policy planning, resource management, and the provision of public services, as well as for the development of long-term strategies in various sectors such as education, healthcare, infrastructure, and the economy. The information collected through the census is crucial for understanding demographic changes, identifying the needs of the population, and determining priorities for sustainable development. In this context, the analysis of population numbers in the municipalities of Kosovo offers a clear overview of territorial distribution, socio-economic characteristics, and the impact of various factors on local development. This study aims to examine changes in the number of inhabitants, households, and dwellings in Kosovo's municipalities, based on the 2024 census data and compared with the results of the 2011 census. The goal is to highlight the main trends of population growth or decline at both municipal and regional levels, to identify the key factors influencing these changes, and to assess their impact on socio-economic development and public service planning. The methodology applied in this study combines the analysis of scientific literature, official census data, and cross-period comparisons. The analysis focused on identifying population change trends in urban and rural municipalities, taking into account socio-economic factors, internal and external migration, urbanization, family structure transformations, and infrastructure development. Primary data from the 2024 Census of Population, Households, and Dwellings were combined with a review of existing literature. The analytical method included a comparison of the 2011 and 2024 censuses to identify trends of population growth or decline, changes in gender structure, urban and rural distribution, as well as the impact of socio-economic and migratory factors. The analysis also categorized municipalities by city size, using Hivzi Islami's classification, which distinguishes large, medium, and small cities, as well as smaller towns. This comparative and analytical approach made it possible to understand not only the number of inhabitants but also the changes in territorial distribution and their implications for local and national policy

planning. The results of the 2024 census show that Kosovo has a total of 1,585,566 inhabitants, with a nearly balanced gender structure: 50.2% male and 49.8% female. This reflects a stable gender balance, typical of a society with relatively steady demographic dynamics. Spatial distribution indicates that 50.18% of the population lives in urban areas and 49.8% in rural areas, reflecting an ongoing shift toward a more even distribution across the country's territory and a gradual process of urbanization. The analysis by city size shows that major urban centers such as Pristina (227,882 inhabitants), Prizren (147,246), and Ferizaj (109,255) concentrate the largest share of the urban population and represent the country's most important economic, educational, and administrative hubs. Medium-sized cities, including Gjilan (82,980), Peja (82,745), Podujeva (70,975), Gjakova (78,699), and Mitrovica (64,742), also host a considerable share of the urban population, offering employment and service opportunities. In contrast, smaller towns such as Gračanica (18,486), Shtërpca (10,710), Hani i Elezit (8,533), Junik (3,943), and Mamusha (5,607) represent areas with limited populations, often marked by specific ethnic or administrative features. This diversity highlights Kosovo's complex demographic structure, where population concentration is closely linked to economic and educational opportunities. A comparison with the 2011 census shows significant shifts in population distribution. For example, Pristina has continued to grow due to employment opportunities, education, and public services, while rural municipalities such as Lipjan, Malisheva, and Vushtrri have seen population decreases driven by internal migration to cities and emigration abroad, as well as limited economic opportunities. This trend reflects the challenges of maintaining rural vitality and the need for sustainable development in these areas. The main factors influencing population change include the economic and industrial development of urban municipalities, urbanization and the concentration of public and educational services, internal migration and emigration abroad, transformations in family structures, infrastructure development, and local and national policies. The urban population concentrates in economic and administrative centers due to greater opportunities for employment, education, and services, while the rural population maintains strong historical ties to land, agriculture, and local traditions. The analysis of territorial distribution and the comparison with the 2011 census reveal a diverse demographic mosaic. Urban regions show population growth and higher service concentration, while rural regions face population decline and fewer economic opportunities. This mosaic clearly reflects Kosovo's socio-economic and demographic diversity and emphasizes the importance of detailed analysis

for understanding both the challenges and opportunities of municipal development. Furthermore, the study highlights that migration, urbanization, and family structure transformations affect not only population distribution but also labor market dynamics, urban planning, and social policy at both local and national levels. The comparison of the 2011 and 2024 censuses provides a clear understanding of demographic dynamics and helps identify municipalities with rapid growth or significant decline, thereby enabling more accurate planning for local and national development. In conclusion, this study offers a comprehensive analysis of demographic and economic changes across Kosovo's municipalities, highlighting urbanization trends, rural depopulation, the impact of socio-economic and migratory factors, and the importance of these changes for sustainable development. The findings provide an important basis for further research on migration, urbanization, socio-economic development, and resource management in Kosovo, contributing to the improvement of development policies and strategies at the national level.

**Keywords: Population Census, Population, Municipalities, Urbanization, Migration, Te**

